



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO			
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE			
Njësia org. Org.Jediniça Org.Unit	M-01	Nr i Prot. Broj Prot. Prot. No.	3143/21
Nr i Faqeve Br. Stranica No Pages	02	Data: Datum: Date:	11.08.21
PRISHTINË / A			No. 1

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government
Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Kabineti i Ministrit

Kabinet Ministra

Cabinet of the Minister

Nr.:...../.....
Data: 11.08.2021

Ministri i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të paragrafit 2 dhe 3 të nenit 52 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe duke u bazuar në nenin 10 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, nenin 8 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, paragrafëve 1 dhe 2 të nenit 6, paragrafit 1.7, 1.8 dhe 1.9 të nenit 9 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit nxjerrë:

V E N D I M

1. Për vendosjen e moratoriumit për hapjen e guroreve te reja dhe në procedurë për pëlqim mjedisor për periudhën dy vjeçare Qershor 2021- Qershor 2023.
2. Me vendim të ministrit themelohet Grupi Punues ministror për vlerësimin e ligjshmërisë së aktiviteteve të guroreve, ndikim e tyre në mjedis dhe masave që duhet të ndërmerren për rehabilitim.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

ARSYETIM

Me qëllim të shfrytëzimit të qëndrueshëm të resurseve natyrore, zvogëlimit të shkarkimeve të ndotjes në mjedis, parandalimin e dëmtimit, rehabilitimin dhe përmirësimin e mjedisit të dëmtuar nga guroret, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, merr vendim për vendosjen e moratoriumit për dhënien e pëlqimeve mjedisore për guroret në nivel vendi.

Masa e moratoriumit do të vendoset për një periudhë dy vjeçare, me ç'rast do të vlerësohen nevojat për hapjen e guroreve te reja, dëmet mjedisore që kanë shkaktuar, përmbushjen e obligimeve



ligjore nga operatorët ekonomik dhe masat që duhet të ndërmarrë Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, lidhur me rehabilitimin e guroreve të pa rehabilituara.

Me hyrjen në fuqi të këtij vendim shfuqizohet vendimi me Numër Protokolli: 2534/21, datës: 28.06.2021

Liburn Aliu

Ministër i MMPHI-së



Vendimi i dërgohet:

- *Kabinetit të Ministrisë*
- *Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm*
- *Komisionit për Miniera dhe Minerale*
- *Ministrisë së Ekonomisë*
- *Komunave të Kosovës*
- *Arkivit të MMPHI-së*

